

Tiranë, më \_\_. \_\_. 2023

**Formulari Nr.3**

**Autoriteti Kontraktor  
ALBCONTROL SHA**

**FTESA PËR OFERTË**

Autoriteti Kontraktor ALBCONTROL SHA do të zhvillojë procedurën e prokurimit për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar nr. 2214/1 Prot. me objekt: “Blerje bilete të transportit ajror ndërkombëtar, me destinacion Luksemburg”.

Data e zhvillimit do të jetë 10.10.2023, ora 12:30 në adresën [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al).

Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj për këtë objekt prokurimi me këto të dhëna:

1. Biletë Tiranë – Luksemburg – Tiranë, nisja më datë 22.10.2023 dhe kthimi më datë 28.10.2023, për 3 (tre) persona.
  2. Biletë Tiranë – Luksemburg – Tiranë, nisja më datë 29.10.2023 dhe kthimi më datë 01.11.2023, për 2 (dy) persona.
- Operatori ekonomik i renditur i pari, përpara se të shpallet fitues, duhet të dorëzojë, dokumentat sipas **shtojcën nr. 1, ku gjeni dhe detajet e itinerareve të fluturimit:**

## **Shtojca nr. 1**

Operatori ekonomik i renditur i pari, përpara se të shpallet fitues, duhet të dorëzojë, dokumentat si më poshtë:

- a) Rezervimin e biletës, sipas destinacionit të kërkuar me itinerare të detajuara, duke përfshirë klasin, sasinë, statusin dhe të dhëna të tjera alfanumerike që kanë të bëjnë me segmentet e udhëtimit si dhe kodin e llogarisë së klientit.

*Në rast anullimesh apo vonesash nga kompanitë ajrore të fluturimit, Operatori Ekonomik do të bashkëpunojë me Autoritetin Kontraktor për riorganizimin e Itinerarit.*

- Shpenzimet e transportit përfshijnë udhëtimin me avion me destinacion Luksemburg sipas itinerarit si mëposhtë:

- a. Itinerari (1): **Tiranë – Luksemburg– Tiranë, për 3 (tre) persona, si mëposhtë:**

- **Nisja** nga Tirana për 3 persona, më datë **22.10.2023**, të bëhet jo më herët se ora 09:00 AM, të ketë jo më shumë se një tranzit dhe mbërritja në Luksemburg jo më vonë se ora 19:00 PM.
- **Kthimi** nga Luksemburgu më datë **28.10.2023**, të bëhet jo më herët se ora 14:00 PM, të ketë jo më shumë se një tranzit dhe mbërritja në Tiranë, jo më vonë se ora 00:00 AM.

- b. Itinerari (2): **Tiranë – Luksemburg– Tiranë, për 2 (dy) persona, si mëposhtë:**

- **Nisja** nga Tirana për 2 persona, më datë **29.10.2023**, të bëhet jo më herët se ora 06:00 AM, të ketë jo më shumë se një tranzit dhe mbërritja në Luksemburg jo më vonë se ora 15:00 PM.
- **Kthimi** nga Luksemburgu më datë **01.11.2023**, të bëhet jo më herët se ora 14:00 PM, të ketë jo më shumë se një tranzit dhe mbërritja në Tiranë, jo më vonë se ora 00:00 AM.

- *Sqarim: Në rastet e fluturimeve me tranzit, preferohet që koha tranzite të jetë mbi 1 orë, për shkak të procedurave dhe vonesave të ndryshme që mund të krijohen në nyjet e kontrollit që ushtrohen në aeroporte.*

- Minimalisht 1 (një) bagazh dore dhe 1 (një) valixhe bagazh max deri në 20 kg (on board, hand luggage dhe check-in baggage)/për person në vajtje dhe ardhje i përfshirë.
- Klasi ekonomik.

- b) Dokumenta të tjera:

- Operatori ekonomik të paraqesë Ekstraktin e QKB-së, ku aktiviteti tregtar të jetë objekt i kësaj procedure si dhe statusi të jetë aktiv.
- Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë që është i pajisur me certifikatë akreditimi/marrëveshje lëshuar nga/me International Air Transport Association (I.A.T.A.), të vlefshme për vitin 2023 dhe valideti të jetë i verifikueshëm online.

- Afati i dorëzimit të dokumentave në sistemin e prokurimit elektronik sipas Ftesës për Ofertë, të bëhet brenda 2 orëve nga momenti i publikimit të njoftimit të fituesit në SPE.

Në ofertën e tij, ofertuesi duhet të paraqesë të dhënat e plota të kontaktit.

**Shënim:** *Autoriteti Kontraktor në zbatim të ligjit Nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, i ndryshuar, do pranojë të likujdojë vetëm fatura elektronike për shërbimin e marrë.*

- \* *Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, apo mosdorëzimi i biletave të udhëtimit sipas termave të referencës dhe grafikut të itinerarit, konsiderohen si kushte për skualifikim.*
- \* Në rast të pamundësisë së realizimit të objektit të prokurimit, jeni të lutur të njoftoni në sistemin elektronik të app-së brenda afatit të përcaktuar në Ftesën për Ofertë nga shpallja e njoftimit të fituesit.

## **TITULLAR I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Laureta Omeri**